

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtruesi: Mbrojtja e Kadri Veselit

Data: 3 maj 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Parashtrimit të Zyrës Administrative
KSC-BC-2020-06/F00252-RED**

Zyrës së Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Dejvid Hupër

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

**Shefes së Zyrës së Pjesëmarrjes së
Viktimave**
Zilke Shtuxhinski

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

I. HYRJE

1. Mbrojtja e z. Kadri Veseli ("Mbrojtja"), në parim, nuk kundërshton kërkesën e Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave ("ZPV") për përdorimin e formularit elektronik të kërkesës në "raste të jashtëzakonshme". Nëse nënshkrimi elektronik bashkë me zotimin solemn mjaftojnë për të garantuar vërtetësinë e kërkesës së një viktime dhe nëse rrethanat kur përdoret formulari elektronik i kërkesës mund të konsiderohen si "të jashtëzakonshme", janë aspekte për të cilat, në fund, vendos Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Megjithatë, Mbrojtja parashtroi se janë të domosdoshme disa garanci procedurale për ta udhëzuar Gjykatësin e Procedurës Paraprake në ushtrimin e kompetencës diskrecionale kur të vendosë mbi pranueshmërinë e kërkesave të viktimave të parashtuara përmes formularit elektronik të propozuar të kërkesës.

II. HISTORIKU PROCEDURAL

2. Më 4 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat ("Vendimi Kornizë").¹
3. Më 16 prill 2021, ZPV-ja parashtroi versionin konfidencial të Kërkesës për autorizim për të përdorur një formular elektronik të kërkesës për pjesëmarrje si viktimë ("Kërkesa").²
4. Më 26 prill 2021, kërkesa iu njoftua palëve në versionin e redaktuar.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Neni 22(3) i Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") përcakton si vijon:

"Rregullat e Procedurës dhe Provave të Dhomave të Specializuara ... përcaktojnë edhe përmbajtjen dhe procedurën për paraqitjen dhe pranimin e kërkesës për të marrë pjesë në procedurë dhe për të deklaruar dëmin."

¹ KSC-BC-2020-06/F00159 ("Vendimi Kornizë")

² KSC-BC-2020-06/F00252.

6. Rregulla 113(1) e Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") përcakton se:

"... një person që pretendon se është viktimë e një vepre penale të pretenduar në aktakuzë, mund të bëjë kërkesë për pranim si viktimë pjesëmarrëse në proces, në të cilën saktëson se si i përmbush kriteret si viktimë dhe jep vendin dhe datën e veprës penale që pretendohet se ka shkaktuar dëm. Formularët e kërkesës nuk u bëhen të njohura palëve."

7. Rregulla 113(2) më tej përcakton se:

" Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave regjistron dhe vlerëson kërkesat dhe ia dorëzon trupit gjykues, së bashku me një rekomandim për pranueshmërinë"

IV. PARASHTRIMET

8. ZPV-ja me të drejtë pohon se në Rregullore nuk shtjellohet forma dhe përmbajtja e saktë e kërkesës për pjesëmarrje si viktimë, as nuk kërkohet që parashtruesi i kërkesës të vendosë fizikisht nënshkrimin në dokumentin përmes së cilit parashtron kërkesën.

9. Pavarësisht nga sa më lart, në Vendimin Kornizë përcaktohet qartë se kërkesa e viktimës do të konsiderohet "e plotë" vetëm në qoftë se plotësohen kriteret minimale dhe kumulative të paragrafit 22 të tij.³ Njëri prej kritereve themelore të sipërpërmendura është që kërkesa të jetë "e nënshkruar".

10. ZPV-ja tani i drejtohet Gjykatësit të Procedurës Paraprake me atë që në fakt është një kërkesë për rishikimin e Vendimit Kornizë të lëshuar katër muaj më parë. Arsytet e dhëna për një rishikim të tillë janë të dyfishta: 1) përvoja e ZPV-së, e cila i

³ Vendimi Kornizë, para 22: "Që një kërkesë të konsiderohet e plotë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se duhet të përmbushen së paku kriteret në vijim: (i) ka prova të mjaftueshme për identitetin dhe, nëse ka lidhje, lidhjen familjare dhe/ose kujdestarinë ligjore; (ii) të dhënat personale janë të plota; (iii) të gjitha pjesët e formularit të kërkesës janë plotësuar; (iv) data/periudha dhe vendndodhja e krimit, si dhe dëmi i pësuar janë shënuar mjaftueshëmrisht qartë; (v) është paraqitur dokumentacion i rëndësishëm dhe i mjaftueshëm për aq sa ka qenë e mundshme; dhe (vi) kërkesa është nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës ose kujdestari ligjor i tij/saj".

ka mësuar asaj se një numër viktimash që bëjnë kërkesë për pjesëmarrje në proces janë të detyruar të mbështeten në palë të treta për shërbimet e printimit dhe skanimit, duke e ekspozuar veten ndaj rreziqeve, dhe 2) pengesat e “mbylljes”, të shkaktuara nga pandemia e Kovid-19.

11. Mbrojtja parashtrohet se në kohën kur lëshoi Vendimin Kornizë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake qartë parashikoi dy arsye për rishikim të paraqitura nga ZPV-ja. Fakti që këto arsye nuk u morën parasysh në Vendimin Kornizë sugjeron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk i konsideroi ato si rrethana mjaftueshmërisht “të jashtëzakonshme” për të hequr kriterin e nënshkrimit fizik. Në të vërtetë, fakti që disa parashtrues kërkesash mund të jenë të detyruar të përdorin shërbimet e printimit të palëve të treta nuk shpjegon pse këta parashtrues nuk mund të kërkojnë ndihmën e një avokati vendor për viktimat, i cili do të ketë detyrimin etik të respektimit të fshehtësisë profesionale. Për më tepër, pandemia e Kovid-19 dhe problemet logjistike të shkaktuara nga kufizimet e “mbylljes” kanë prekur popullsinë globale që prej shkurtit 2020.

12. Krahasoni që bën ZPV-ja me precedentin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare (“GJPN”) është i pavend. Formatu elektronik u përdor në çështjen *Abd-al-Rahman* për shkak të problemeve të veçanta të hasura nga viktimat në Darfur, Sudan, ku “niveli i teknologjisë së komunikimit në përgjithësi është i ulët, pajisjet e teknologjisë së informacionit shpesh kufizohen në pajisje të thjeshta, të tilla si kompjuterë personalë, tableta dhe telefona *smart* (dhe pa kapacitete për skanim dhe/ose printim)”.⁴ Megjithatë, para vitit 2019, në të gjitha çështjet e GJPN-së - disa prej të cilave u kryen në rajonet më sfiduese të botës - për pjesëmarrjen e viktimave kërkohej nënshkrimi fizik në një formular standard “të shtypur” të kërkesës.

13. ZPV-ja ka për detyrë të vlerësojë kërkesat para parashtrimit të rekomandimeve të saj para panelit që merr vendimin mbi pranueshmërinë e tyre.

⁴ ICC-02/05-01/20-178-Red 02-11-2020 në para 8.

Rregulla 113(1) nuk i lejon Mbrojtjes të luajë rol në këtë detyrë të rëndësishme e cila mund t'i japë një viktime që bën kërkesën të drejtën për kompensim financiar nga një i akuzuar, në rast se ai shpallet fajtor. Në këto rrethana, nënshkrimi fizik, apo madje dhe shenja e gishtit të madh, shërben për të konkretizuar konfirmimin nga viktimë që bën kërkesën se informacioni që ai/ajo ka dorëzuar është i vërtetë dhe se ai/ajo mund të jetë objekt i procedurave penale për dhënie të informacionit të rremë, në qoftë se informacioni i dhënë konstatohet se është qëllimisht i rremë. Ky kriter gjithashtu siguron masat mbrojtëse kompensuese të nevojshme kundrejt dëmit të mundshëm që mund t'u shkaktohet të drejtave të Mbrojtjes nga një sistem tejet lejues i parashtrimit të kërkesave.

14. Gjithsesi dhe siç lihet të kuptohet nga sa më lart, Mbrojtja pajtohet se në disa raste mund të ekzistojnë "rrethana realisht të jashtëzakonshme" që e pengojnë viktimën që bën kërkesën të vendosë fizikisht nënshkrimin e vet në formularin standard. Për këtë arsye, Mbrojtja, në parim, nuk e kundërshton përdorimin e formularit elektronik të kërkesës kur është absolutisht e domosdoshme.

V. PËRFUNDIM

15. Gjykatësit të Procedurës Paraprake me respekt i kërkohet që të kushtëzojë kërkesën e ZPV-së për përdorimin e formularit elektronik të kërkesës, me çka hiqet kriteri i nënshkrimit fizik, me dy kushtet e mëposhtme:

- i) Që në tekstin e propozuar të zotimit solemn në formularin elektronik të kërkesës të përfshihet tekst ku viktimës që bën kërkesën t'i kërkohet të konfirmojë se është në dijeni të pasojave ligjore të dhënies së informacionit të rremë si në shtetin ku banon ashtu edhe para Dhomave të Specializuara të Kosovës, dhe;
- ii) Që formulari elektronik të detyrojë viktimën që bën kërkesën të përshkruajë "rrethanat e jashtëzakonshme" që e pengojnë atë të vendosë

fizikisht nënshkrimin në kërkesë.

Numri i fjalëve (në origjinal): 1108

_____/nënshkrimi/

Ben Emerson, CBE QC

**Mbrojtësi i Specializuar
i Kadri Veselit**

_____/nënshkrimi/

Nikolas Kaufman

**Bashkëmbrojtësi i Specializuar
i Kadri Veselit**

Data: 3 maj 2020